



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.765/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtare në Kuvend Komunal në Kamenicë Jona Arifi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Pranohet pjesërisht** si i bazuar apeli Anr.765/2021 i datës 04.11.2021 paraqitur nga kandidatja për anëtare për Kuvend Komunal në Kamenicë Jona Arifi nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë.
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet vetëm për Kandidaten për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë Jona Arifi nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, në Qendrën e Votimit 1024D/01R, 1024D/04D, dhe 1024D/02R.
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.
- IV. **Refuzohet** si e pabazuar pjesa tjetër e apelit të për vendvotimet 1009D/03R dhe 1009D/01R, 1009D/02R, 1024D/03R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë Jona Arifi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë në të cilën pretendon se ka fakte të pamohueshme se votat e saj janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i ka dhënë votuesi. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa dëshmitarëve. Duke qenë e bindur në parregullsi në procesin e

votimit ka kërkuar nga PZAP që në Qendrat e Votimit 1024D-01R, 1024D-04D, 1024D-03R DHE 1024D-02R, 1009D-01R dhe 1009D-02R të dërgohen në rinumërim për shkak se votat e familjarëve dhe miqve të saj në këto qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i saj është dëmtuar. Si dëshmi apelit i ka bashkangjitur deklaratat e personave që e kanë votuar ndërsa në këto vendvotime i figurojnë 0 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Jona Arifi kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Qendrën e Votimit 1024D-01R, 1024D-04D, 1024D-03R DHE 1024D-02R, 1009D-01R dhe 1009D-02R

Paneli vlerëson se apeli është pjesërisht i bazuar vetëm sa i përket vendvotimeve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që mbështetet edhe në prova të dorëzuara nga kandidatja, ku shihet se nga deklaratat e gjithsej tre votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarinimin se në vendvotimet 1024D/01R, 1024D/04D dhe 1024D-02R e kanë votuar kandidaten Jona Arifi nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Gjithsej vota në këto vendvotime kanë rezultuar 0 derisa nga deklaratat e dëshmitarëve ishte dashur të jenë 4 vota.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës me të cilën refuzohet si në pikën IV e pa bazuar ankesa për kutin me numër 109D/03R pasi që në bazë të kërkimeve të realizuara rezulton se një vendvotim i tillë nuk ekziston si dhe për vendvotimet 1009D/02R, 1009D/01R, 1024D/03R rezulton se ka gjithsej 12 vota, çka e pamundëson rinumërimin për shkak të mungesës së fakteve.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.765/2021 më datën 06.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.